REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA E BOTIMEVE ZYRTARE

Nr. 1385/6 Prot.

Tiranë më, 25.09.2023.

LËNDA: Njoftim për krijimin e vendit vakant , shpalljen e kritereve për pozicionin dhe plotësimin e tij.

DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

TIRANË

Pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare është krijuar vendi vakant në pozicionin **Redaktor,** Specialist në nivelin ekzekutiv, kategoria e pagës III- b, në Sektorin e Arkivës Elektronike për arsye të largimit të nëpunëses Elona Baçi me kërkesën e saj të motivuar pasi është shpallur fituese dhe emëruar në përfundim të procedurës së konkurimit, në vendin vakant pranë zyrës së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, në pozicionin Specialist, Sektori i Kërkesave për Qëllime Studimore, Media, Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar.
Për këtë arsye kërkojmë nga ana juaj plotësimin e vendit vakant që krijohet në pozicionin e sipërcituar.

- **Pozicioni:**

Redaktor në Sektorin e Arkivës Elektronike pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, kategoria e pagës III – b.

- **Kriteret e veçanta:**

Të zotërojë diplomë të nivelit Master Shkencor në shkencat juridike dhe diploma e nivelit bachelor të jetë e së njëjtës degë.

Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune.

- **Përshkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës, Redaktor në Sektorin e Arkivës Elektronike.**

Përditëson legjislacionin ligjor dhe nënligjor, sipas ndryshimeve që ndodhin në Fletoren Zyrtare.

Përgatit planin e punës për përditësim në bazë të ndryshimeve të ndodhura në Fletoren Zyrtare

Përgatit përmbledhëset e legjislacionit sipas planit të punës të miratuar nga titullari i institucionit;

Përfaqëson institucionin me autorizim në çështjet gjyqësore me të tretët;

Përgatit të gjitha aktet shkresore të nevojshme për ecurinë e gjykimit ku është caktuar si përfaqësues mëe autorizim;

Harton dhe koncepton korrespondencën e institucionit me institucione të tjera;

Merr pjesë në hartimin e procedurave dhe standarteve ligjore kur legjislacioni i fushës kërkon një gjë të tillë;

Merr pjesë dhe harton dokumentat e nevojshme për procedurat e prokurimit;

- **Fushta e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurimi, kandidatët duhet të vlerësohen në lidhje me:**

Njohuritë mbi kushtetutën,

Njohuritë mbi Kodin e Procedurës Adminisrtative,

Njohuri mbi teknikën legjislative,

Njohuri mbi procedurën e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative;

Njohuri mbi ligjin "Për organizimin dhe funksionin e Qendrës së Botimeve Zyrtare",

(nr. 78/2014),

Njohuri mbi ligjin "Për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore", (Ligji nr. 90/2012),

Njohuri mbi ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin Civil", i ndryshuar,

Njohuri mbi ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik", i ndryshuar,

Duke ju falenderuar për bashkpunimin dhe mirrkuptimin,

REPUBLIKA E SHQIPËRISË QENDRA E BOTIMEVE ZYRTARE MINISTRIA E DREJTËSISË TIRANË

DREJTOR

Etleva HAXHIA

Konceptoi M.Progonati
Miratoi: Lloja
Nr. i kopjeve 2(dy)